

Titulli i lëndës: HISTORIA E ARKITEKTURËS – KOHA E RE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	Historia e Arkitekturës – Koha e Re
Niveli:	BscA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Ass.Dr. Florina Jerliu, Prof.Ass.Dr.Kaltrina Thaçi Cenaj
Të dhënat kontaktuese:	florina.jerliu@uni-pr.edu , kaltrina.thaci@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Historia e Arkitekturës – Koha e Re shtjellon krijimtarinë arkitektonike në kontekst dhe kronologji kohore të periudhës historike midis shekujve XV dhe XX. Ilustrimi i trendeve dhe stileve arkitektonike bashkë me kontekstet e zhvillimit të tyre teorik dhe praktik analizohen nëpërmjet shembujve ilustrues të arkitekturës dhe të arkitektëve të cilët e definojnë kuadrin e krijimtarisë arkitektonike dhe urbanistike përgjatë historisë
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me veçantitë e periudhave artistike bashkë me elementet dhe parimet e arkitekturës, të aplikuara prej Renesancës deri te Modena; të përvehtësohen kornizat themelore kronologjike dhe gjeografike të historisë së arkitekturës (arkitektura në kohë dhe hapësirë); të zgjerohet dija mbi kulturën ndërtimore; të njihen fillet e vlerësimit të raporteve midis idesë dhe formës së objektit brenda kontekstit të gjërë të social, politik dhe ekonomik. Të fitohet shkathtësi në analizën arkitektonike të monumenteve botërore dhe parashtrimin e saj në formë eseje sipas standardit akademik.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none">– interpretojë periudhat artistike në kronologji historike– identifikojë karakteristikat themelore artistike të periudhave historike– analizojë dhe interpretojë veprat e rëndësishme artistike dhe kontekstin e tyre (sipas periudhave stilistike, vendit, drejtimeve, tipeve, strukturës, materialit dhe teknikës së aplikuar)

	– Aplikojë njohuritë e fituara në kualifikimin e veprave të artit në hulumtimin akademik
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Njohja e historisë së arkitekturës, përkatësisht, kontekstit historik dhe artistik të veprave arkitektonike dhe urbane kulminante të civilizimit njerëzor përbën referencën themelore të njohurive gjithëpërfshirëse të botës së arkitekturës dhe njëherit burimin e rëndësishëm të dhe të nevojshëm në procesin e rafinimit akademik dhe profesional të studentëve të arkitekturës.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	14	7
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			
Total			100

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive, diskutimeve, detyrë shtëpie individuale dhe grupore, prezantime të punës së studentëve
--------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<i>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%. Vijueshmëria dhe angazhimi aktiv në klasë i studentit 10%; Detyrat /prezantimet individuale 40% Vlerësimi nga testet 25% ose provimi final 50%</i>
------------------------------	---

Literatura primare:	Nixha, S. dhe Jerliu, F. (2007) Dispencë: Historia e Arkitekturës. Prej Renesancës deri te Moderna. Shekujt XV-XIX Ching, F.D.K. et.al. (2017) A Global History of Architecture, Wiley, New Jersey M. Moffet, M. Fazio, L.Wdenhouse (2004) A World History Of Architecture; P. Nuttgens (1983) The Story Of Architecture;
----------------------------	--

Literatura shtesë:	Trachtenberg, I. Hyman (2003) Architecture From Prehistory To Post-Modernism;
---------------------------	---

	Robert Harbison (2009) Travels in the History of Architecture, Reaktion Books Fletcher, Bannister (1996): A History of Architecture on the Comparative Method; L.S.Adams (2001) Key Monuments of the Italian Renaissance, Avalon Publishing Christian Norberg-Schulz (2003) Baroque Architecture, Phaidon Incorporated Limited; R.Toman, A. Bednorz (2010) Neoclassicism and Romanticism, H.F.Ullmann Publishing
--	--

Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratës	Ushtrimet
Java 1:	Hyrje në lëndë: katakteristikat sociale-artistike të periudhës	Hyrje në analizën e historike të arkitekturës
Java 2:	Koncepti i Renesansës në arkitekturë, hapësirë dhe shoqëri.	Caktimi i detyrave, ese (1)
Java 3:	Gjuha e ndërtimit klasik: elementet dhe marrëdhëniet	Burimet e vërtetuara dhe plagjiati
Java 4:	Arkitektura e Renesanses së hershme. (Quattrocento)	Analiza përmbajtësore
Java 5:	Arkitektura e Renesanses së të Lartë (Qinkueqento)	Prezantim i studentëve, ese 1
Java 6:	Renesansa e vonë/Manierizmi	Caktimi i detyrave, ese (2)
Java 7:	Renesanca veriore	Burimet e vërtetuara dhe plagjiati
Java 8:	Vlerësimi intermediar (testi 1)	
Java 9:	Arkitektura e Barokut. Nocionet dhe konceptet. Fillet e Barokut shek. XVII	Analiza krahasimore
Java 10:	Baroku dhe Klasicizmi, shek. XVIII	Prezantim i studentëve, ese 2
Java 11:	Neoklasicismi. Romantizmi, Eklekticismi: fundshek. XVIII – XIX	Caktimi i detyrave, ese (3)
Java 12:	Arkitektura e revolucionit industrial: teknologjia e lartë	Analiza arkitekturale
Java 13:	Arkitektura e kohës së re në vendet tjera të botës	Analiza arkitekturale
Java 14:	Arkitektura e kohës së re në trojet shqiptare	Prezantim i studentëve, ese 3
Java 15:	Vlerësimi përfundimtar (testi 2)	Dorëzimet finale

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ligjëratat janë obligative; ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë; inkurajohet dhe vlerësohet bashkëbisedimi dhe interaksioni gjatë analizës së veprave arkitektonike; folësi dëgjohet nga të gjithë; inkurajohet shfrytëzimi i teknologjisë së mençur për diskutime dhe prezantime të tipit “fun facts”, ndërsa nuk lejohen përdorimi i tyre për aktivitete tjera si kontrollimi i e-mailit personal apo rrjeteve sociale.

Shënim | Nëse detyra seminarike e një studenti vlerësohet nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final.